

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. ZD
Dep.
Dep.
Nr. I faq.
Broj stranica
Nr. pages

Nr. Prot. 04-1346/15
Br. Prot.
Prot No.
Data
Datum
Date 14.05.2015

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	08.05.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Sasha Popović, Kryesues i Kuvendit te Komunës se Zveqanit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupcionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion- lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik

Inderuar z. Popović

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupcionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 pika 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik

Lidhur me kërkesën tuaj nr (DPK-03-02-1217/15), drejtuar Agjencisë kundër Korrupcionit ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupcionit dhe mandatit qe ka lidhur me çështjen e konfliktit e interesit, dhe papajtueshmërisë gjate ushtrimit te funksionit publik te paraparë sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejmë Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), Agjencia kundër Korrupcionit, ndër të tjera, bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eproreve, të institucioneve e prore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave (neni 19, pika 1.5).

Prandaj, duke u përgjigjur pyetjes tuaj te paraqitura ne kërkesën tuaj drejtuar AKK-së, për sqarimin e situatës qe ndërlidhet me funksionin tuaj si Kryesues i Kuvendit të Komunës se

Zveqanit dhe mundësisë se punësimit tuaj ne Doganën e Kosovës “ se a mundëm si këshilltarët komunal gjatë mandatit te këshilltarit komunal, Kryesues i Kuvendit të Komunës se Zveqanit të punësohem edhe në Doganën e Kosovës, Agjencia kundër Korruptionit si institucion i pavarur dhe kompetent për parandalimin e konfliktit të interesit ne ushtrim te funksionit publik, në bazë te informatave te ofruara nga ju nxjerr këtë:

OPINION

Ushtrimi i funksionit publik si Kryesues i Kuvendit të Komunës se Zveçanit, dhe punësimi në Doganën e Kosovës, në funksione qe nuk hyn ne kategorinë e zyrtareve të lart të paraparë sipas nenit 4 të Ligjin Nr. 04/L-051, nuk paraqet kufizim në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë është i obliguar që në rast të paraqitjes eventuale të ndonjë situate me konflikt “rast për rast” të interesit, të bëjë deklarimin paraprak të interesave private (konform neni 13, paragrafi 1,2,3).

Arsyetim

Anëtarët e Kuvendit të Komunës, Kryesuesi, drejtoret e drejtorive komunale, hynë ne listën e zyrtareve të lartë publikë sipas nenit 4 te Ligjin Nr. 04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, duhet theksuar se është obligim i çdo zyrtari qe te respektoj te gjitha ligjet ne fuqi, andaj është obligim i zyrtareve te larte qe te respektojnë dhe te zbatojnë parimet e veprimit dhe mos veprimit sipas nenit 7 te Ligji nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.


Neni 16.1 Ligjin Nr. 04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik ka parapa kufizim për zyrtarin e lartë ne ushtrimin e funksioneve tjera krahas ushtrimit te funksionit publik, ku nder te tjera thotë se : Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak te funksionit,

Ndërsa ne bazë të nenit 7.6 të ligji Nr. 04/L-051 thuhet se : Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk ka të drejtë të krijojë marrëdhënie varësie nga persona tjerë që do të mund të ndikonin në paanshmërinë dhe shprehjen e vullnetit të lirë në vendimmarje, edhe në piken 8 të këtij neni thuhet se zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm, ndërsa sipas nenit 8 të këtij ligji, te gjithë zyrtarët e lartë kanë detyrë qe të parandalojnë konfliktit të interesit dhe të zgjidhin vetë brenda afatit ligor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit.

Po ashtu është obligim cilit do nga anëtarët e Kuvendit të Komunës qe te zbatoj ninen 38 të ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje, e cila dispozitë flet për Konfliktin e Interesit, ndërsa nëse ju punësoheni ne Doganën e Kosovës jeni te obliguar te zbatoni rregullat dhe legjislacionin qe e rregullojnë çështjen e konfliktit te Interesit brenda Doganës se Kosovës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe besimin e shfaqur ne institucionin tonë ju rekomandojmë te veproni sipas këtij Opinionit dhe ne raste shfaqjes te ndonjë situate me konflikt të Interesit te veproni sipas ligjeve ne fuqi.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	31.05.2015
REFERENC-Ë:	APK-DSK
PËR/ZA/TO:	g. Saša Popović, Predsedavajući Skupštine Opštine Zvečan
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Direktor Agencije protiv Korupcije
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Mišljenje – profesionalni savet u vezi suzbijanja sukoba interesa tokom vršenja javne funkcije

Poštovani g. Popović,

Na osnovu člana 5 (stav 1. tačka 1.12) Zakona br . 03 / L - 159 za Agenciju protiv Korupcije i Člana 19 (stav 1 , tačka 1.6) Zakona br . 04 / L - 051 o Sprečavanju Sukoba Interesa u Vršenju Javnih Funkcija

Što se tiče vašeg zahteva br (DPK-03-02-1217/15), upućenom Agenciji protiv Korupcije, obaveštavamo vas da u okviru svojih ovlašćenja i mandata, a po pitanju sukoba interesa i nespojivosti u toku vršenja Javne funkcije predviđenim po Zakonu za Suzbijanje Sukoba Interesa u Vršenju Javne Funkcije(u daljem tekstu: Zakon za Suzbijanje Sukoba Interesa), Agencija protiv Korupcije, između ostalog, vrši i savetovanje posebnih visokih zvaničnika, prema prepostavljenima, superiornim institucijama, a po njihovom zahtevu za određene pojave slučajeva sukoba interesa(član 19, tačka 1.5).

Prema tome, odgovarajući na vaše pitanje navedenog u zahtevu upućenom AKP za razrešenje situacije vezane sa vašom funkcijom kao Predsedavajući Skupštine Opštine Zvečan i mogućnosti vašeg zapošljavanja u Carinama Kosova” da li mogu kao Opštinski Savetnik,

Predsedavajući Skupštine Opštine Zvečan, da se zaposlim u Carinama Kosova”, Agencija protiv Korupcije kao nezavisna institucija nadležna za suzbijanje sukoba interesa u vršenju javne funkcije, a na osnovu pruženih informacija, donosi sledeće:

M I Š L J E N J E

Vršenje javne funkcije kao Predsedavajući Skupštine Opštine Zvečan, i zapošljavanje u Carinama Kosova, na funkcije koje nisu u kategoriji visokih zvaničnika prema Zakonu br.04/L-051, ne predstavlja ograničenje u vršenju javne funkcije.

Visoki zvaničnik se obavezuje da u slučaju eventualne pojave neke situacije sa sukobom” od slučaja do slučaja” interesa, izvrši preliminarnu deklaraciju privatnih interesa(shodno članu 13,stav1,2,3).

Obrazloženje

Članovi Skupštine Opštine, Predsedavajući, Direktori Opštinskih uprava, ulaze u spisak visokih javnih zvaničnika prema članu 4 Zakona br.04/L-051, za Suzbijanje Sukoba Interesa u Vršenju Javne Funkcije. Treba navesti da je obaveza svakog zvaničnika poštovanje svih zakona na snazi, stoga je obaveza visokih zvaničnika da poštuju i sprovode principe delovanja i nedelovanja prema članu 7 Zakona br . 04 / L - 051 o Suzbijanu Sukoba Interesa .

Član 16.1 Zakona br. 04/L-051, za Suzbijanje Sukoba Interesa u Vršenju Javnih Funkcija je predviđao ograničenje za visokog zvaničnika u vršenju drugih funkcija uporedno sa javnom funkcijom, gde između ostalog stoji: Visoki javni zvaničnik ne može da bude Menadžer ili član menadžerskih profitabilnih i neprofitabilnih organizacija, isključujući političke subjekte kao I slučajevе kada se jedna takva funkcija namenjuje zbog funkcije.

Dok se na osnovu člana 7.6 Zakona br . 04 / L - 051 navodi da : Visoki zvaničnik tokom vršenja javne funkcije nema pravo da stvara odnose zavisnosti od drugih lica koji bi mogli da utiču na nepristrasnost i izražavanju slobodne volje na odlučivanje, a u tački 8 ovog člana se kaže da : Visoki zvaničnik ne treba dozvoliti da njegovi privatni interesi dolaze u sukob sa njegovom funkcijom. On treba da izbegava sukob interesa nezavisno ukoliko je on realan, ili moguć, dok prema članu 8 ovog zakona , svim visokim zvaničnicima imaju obavezu da sprečavaju sukobe interesa i reše u zakonskom roku, a na najefikasniji mogući način, svaku situaciju njihovog konflikta interesa.

Takođe je obaveza svakog člana Skupštine Opštine da sprovodi član 38 Zakona Br.03/L-040 za Samoupravu, gde se u ovoj odredbi govori o Sukobu Interesa, a, ukolike se vi zaposlite u Carini Kosova,onda ste dužni te da poštujete pravila i zakone koji regulišu pitanje sukoba interesa unutar Kosovske Carine .

Zahvaljujući se na saradnji i prikazanom poverenju u našu ustanovu, preporučujemo vam da postupite po ovom Mišljenju i u slučaju pojave bilo kakvog sukoba interesa, postupate u skladu sa važećim zakonima.

S poštovanjem!